



„Tryeza e rrumbullakët kundër dhunës shtëpiake“ e Dortmundit

Përdhunimi / shtrëngimi seksual
Udhëzime dhe informacione
për gra të prekura

■ Përmbajtja

Çfarë është dhuna e seksualizuar?	4
Pasojat e mundshme	6
Përkujdesja mjekësore	8
Sigurimi i anonimizuar i gjurmëve	8
Mundësitë ligjore	10
<i>Kallëzimi penal</i>	
<i>E drejta për padi dytësore</i>	
<i>Shoqërimi psiko-social gjatë procesit</i>	
Përkujdesja vetjake	15
Oferta për mbështetje e këshillimores për gra	17

E dashur lexuese!

Me këtë broshurë ne dëshirojmë t'ju informojmë se çfarë mund të bëni ju, nëse ju jeni prekur nga dhuna e seksualizuar, dhe çfarë mundësish keni pas një përdhunimi / shtrëngimi seksual. Ne dëshirojmë që t'ju mbështetim gjatë respektimit dhe realizimit të të drejtave tuaja dhe t'ju vëmë në dispozicion informacione, të cilat duhet të jenë këshillë dhe ndihmë për ju.

Nuk ka pothuajse asnjë studim që e pasqyron përmasën e vërtetë dhe format e ndryshme të shfaqjes së dhunës së seksualizuar kundër grave. Sipas një studimi në shkallën e BE-së nga viti 2014 një në çdo tre gra ka pësuar dhunë fizike dhe/ose të seksualizuar që nga moshja 15 vjeçe.

Më dt. 10.11.2016 ka hyrë në fuqi e drejta e re penale seksuale, të cilën Bundestagu Gjerman e ka vendosur njëzëri në korrik të vitit 2016 në një votim historik. Nëpërmjet sanksionimit të parimit „Jo do të thotë Jo“ kjo reformë paraqet një përmirësim të konsiderueshëm për mbrojtjen e vetëvendosjes seksuale. Sipas ligjit të ri një ndërhyrje seksuale është tashmë e dënueshme, nëse ajo bëhet kundër vullnetit të dukshëm të një personi. Nuk është më me rëndësi, nëse një person i prekur është mbrojtur kundër ndërhyrjes ose pse ai nuk ia ka arritur një gjëje të tillë.

■ Çfarë është dhuna e seksualizuar?

Dhuna e seksualizuar është një temë, mbi të cilën gjatë viteve të fundit në të vërtetë është folur më shpesh dhe gjithashtu edhe në mënyrë më publike, por nuk u arrit ende një trajtim i hapur dhe afër realitetit. Duhet të supozohet për një shifër të lartë të panjohur të veprave jo të kallëzuara penale, sepse ndërhyrje seksuale ndodhin, para se gjithash, në ambientin e afërt shoqëror, d.m.th. atje, ku femrat ndihen më të sigurta: në familje, në partneritete dhe në rrethin shoqëror. Në shumicën e rasteve e prekura dhe autori njihen mirë, dhe të kallëzosh një person të afërt është e lidhur shpesh herë me frenime dhe atëherë kuota e kallëzimit është përkatësisht e ulët.

Dhuna e seksualizuar fillon atje, ku vajzat dhe gratë kufizohen në lirinë e tyre personale. Ky është tashmë rasti, nëse ju duhet të shmangni vende, rrugë ose situata të caktuara, për të mos u fyer, bezdisur ose kërcënuar. Në rast të dhunës së seksualizuar nuk bëhet fjalë vetëm për kënaqësinë seksuale të autorit, por seksualiteti përdoret si instrument pushteti, për ta poshtëruar dhe për ta mposhtur personin tjetër.

Shpesh herë gratë e prekura e kanë ndjenjën që ato kanë një bashkëfajësi për atë që u ka ndodhur atyre ose ato kanë turp për këtë. Krejt pavarësisht nga sjellja, veshjet, shfaqja e tyre - faji është vetëm tek autori!

Askush nuk ka të drejtë që mos t'i respektojë kufijtë tuaja fizike, psikike dhe seksuale.

Ju mund të përballoheni në mënyrë të ndryshme me dhunën e seksualizuar. Dallohet midis formave të ndryshme:

- *Përdhunim dhe shtrëngim seksual (edhe pas përdorimit të pikave narkotizimi)*
- *Dhunë e seksualizuar në partneritet / martesë*
- *Bezdisje seksuale (në jetën e përditshme, në vendin e punës)*
- *Dhunë e seksualizuar gjatë fëmijërisë*
- *Dhunë digjitale (p.sh. në rrjetet sociale)*
- *Ndërhyrja seksuale nga profesionistë (si p.sh. mjekë/mjeke, mësues/mësuese ose terapeutë/terapeute)*

■ Pasojat e mundshme pas një ndërhyrjeje seksuale

Çdo grua i zhvillon strategjitë e veta të përballimit dhe mbijetesës pas një ndërhyrjeje seksuale. Reaksionet janë individuale dhe shumë të ndryshme, përveç kësaj ato varen nga shumë faktorë.

Shqetësimet mund të kenë ndikime në fusha sociale, profesionale dhe të tjera të jetës. Përveç kësaj një përdhunim / shtrëngim seksual mund të ketë pasoja fizike dhe/ose psikike.

Menjëherë pas të përjetuarit shumë gra reagojnë duke rënë në gjendje shoku.

- Nga pamja e jashtme ato mund të duken krejt të qeta dhe të përmbajtura ose ato ligështohen dhe qajnë. Të tjera duken si të shtangura, boshe, të tronditura ose ndihen si të vdekura shpirtërisht. Të tjera tregojnë reaksione të forta emocionuese: Ato janë të zemëruara ose të ngacmueshme, agresive ose të frikshme
- Shumë gra ndiejnë denigrim, poshtërim, frikë, turp, pafuqi, por edhe urrejtje dhe zemërim. Pas një përdhunimi / shtrëngimi seksual pamja e vetvetes është karakterizuar shpesh herë nga ndjenjat e fajit. Si konsekuencë të prekurat tërhiqen përkohësisht nga ambienti i tyre social.

Me kalimin e kohës reaksionet ndaj një ngjarjeje të dhunës ndryshojnë dhe pasojat mund të shfaqen në simptoma të frikës dhe panikut, problematikat e vetëvlerësimit ose në sjellje të vesit.

Kjo radhitje duhet kuptuar si shembull. Nuk ka mënyra të përgjithshme, të parashikueshme të reagimit ndaj një ndërhyrjeje seksuale dhe gjithashtu nuk ka reaksione të drejta ose të gabuara.

Ju nuk jeni të sëmurë ose të marrë, nëse ju i përjetoni në vetvete simptomat e përshkuara ose të tjera.

Të gjitha këto përvojat mund të jenë ngarkuese, por ato shërbejnë që të përpunohet e përjetuara. Ato janë një reaksion normal i trupit/personit tuaj për një ngjarje jo normale.

Një përdhunimi / shtrëngim seksual ose një ndërhyrje seksuale në tentativë u përkasin përvojave më të dhimbshme, të cilat mund të bëjë një grua gjatë jetës së saj.

Nëse ju menjëherë pas përvojës së dhunës dëshironi të shfrytëzoni ndihmë, atëherë ia hapni zemrën një shoku/shoqeje, mjekut tuaj/mjekes suaj ose një personi tjetër. Edhe në këshillimoren për gra në Dortmund ju gjeni një ofertë mbështetjeje.

Për trajtimin e plagosjeve tuaja dhe një shoku të mundshëm ju mund të vizitoni një mjek/e. Vetëm ju vendosni se çfarë dhe kur dëshironi të realizoni.

■ Përkujdesja mjekësore

Pas një përdhunimi / shtrëngimi seksual është e këshillueshme që të bëhet sa më shpejtë që të jetë e mundur një vizitë mjekësore (gjinekologjike). Kjo është e mundshme tek një mjek/e ose në një klinikë me ambulancë gjinekologjike. Çdo mjek/e i nënshtrohet detyrimit mjekësor për të heshtur.

Vizita mjekësore dhe trajtimi mjekësor janë të pavarur nga një kallëzim. Edhe nëse nuk ka plagosje akute trupore, një kontroll mjekësor është i arsyeshëm. Mbani parasysh, ju lutemi, që në rast të një përdhunimi / shtrëngimi seksual ekziston parimisht rreziku i plagosjeve në zonën gjenitale, të infeksioneve me sëmundjeve seksualisht të transmetueshme ose mundësia e një shtatzënie të padëshiruar. Në këtë rast është e mundshme që të merret pilula e emergjencës.

Përveç kësaj mund të shkaktohen lëndime dhe plagë gërvishtjeje, të cilat mund të trajtohen dhe dokumentohen. Mund të bëhen edhe testime për infeksione si HIV (e provueshme gjashtë javë pas kontaktit të riskut), hepatit, sifiliz, gonorre dhe klamida dhe nëse është e nevojshme mund të fillohet një trajtim.

■ Sigurimi i anonimizuar i gjurmëve

Krahas përkujdesjes mjekësore për një kallëzim dhe për kërkesën e pretendimeve sipas së drejtës civile është me shumë rëndësi një dokumentacion i shpejtë (i plagosjeve ose i gjurmëve të mundshme të veprës së dhunshme).

Sigurimi „anonim“ respektivisht i pavarur nga kallëzimi i gjurmëve u mundëson të prekurave një dokumentacion mjekësor me siguri ligjore të plagosjeve të tyre dhe një sigurim gjurmësh pa nevojën e bërjes së menjëhershme të kallëzimit. Kështu ju e keni mundësinë që të mendoni në qetësi, nëse dëshironi të bëni një kallëzim apo jo. Këto gjurmë ruhen, sipas klinikës, deri në 20 vjet për një proces të mundshëm gjyqësor.

Në rast të një sigurimi anonim të gjurmëve provat depozitohen pas një analize me një numër shifror në mënyrë anonime në institutin e mjekësisë ligjore. Policia nuk e merr vesh këtë, nëse nuk bëhet asnjë kallëzim. Nëse bëhet një kallëzim gjatë periudhës prej 10 vjetësh pas një veprë, gjurmët mund të shërbejnë akoma si mjete të rëndësishme të provës. Për sigurimin e gjurmëve dhe gjendjen e provave është **e rëndësishme**, që të mos laheni, me gjithë neverinë tuaj të kuptueshme, dhe të mos pastroni veshjet, përpara se të jetë bërë vizita mjekësore.

Në rajonin tonë është e mundshme të bëhet një sigurim anonim i gjurmëve në këto vendndodhje: <http://www.frauenhaus-dortmund.de/Frauenberatungsstelle-Dortmund/Sexualisierte-Gewalt/Anonymisierte-Spuren-sicherung/140351,1031,139952,-1.aspx>



■ Mundësitë ligjore

Pas një përdhunimi / shtrëngimi seksual shumë gra qëndrojnë para pyetjes, nëse ato duhet ta denoncojnë autorin. Një kallëzim penal është një mundësi që të bëhet publik që është kryer një krim dhe autori të vihet para përgjegjësisë. **Ju vendosni, nëse ju dëshironi të bëni një kallëzim apo jo!** Nga ana ligjore ju nuk jeni e detyruar për këtë. Më poshtë ne i kemi përmbledhur informacionet më të rëndësishme.

Kallëzimi penal

Nëse është e arsyeshme që të bëhet një kallëzim, kjo duhet të mendohet mirë dhe në qetësi. Merrni atë kohë për të cilën keni nevojë; ju nuk duhet ta merrni këtë vendim vetëm. Ju mund të merrni ndihmë dhe këshillë profesional nga një avokat/e ose një bashkëpunëtoreshë të një këshillimoreje për gra.

I parashtruar një herë, një kallëzim penal nuk mund të tërhiqet më në rast të veprave penale seksuale. Sepse me bërjen e një kallëzimi autoriteti i ndjekjes penale fillon një proces hetimor.

Në rast të veprave penale seksuale ka masa të ndryshme të dënimit me afate të ndryshme të parashkrimit. Në një bisedë me një avokat/e mund të sqarohet se si duhet të vlerësohet ndërhyrja seksuale dhe gjatë kësaj mund të bisedohen edhe pyetje për zhvillimin e procesit penal ose afatet e parashkrimit. Avokati/avokatja është i/e detyruar për mbajtjen sekret si avokat/e.

Për të shfrytëzuar një këshillim juridik falas ekziston mundësia tek Gjykata Komunale Dortmund që të merret një fletë autorizimi për të drejtën e ndihmës për këshillim ose nëpërmjet shoqatës 'Weißer Ring' një çek për këshillim.

Për një kallëzim flet p.sh.:

- Bëhet publik që është kryer një vepër penale.
- Nëse arrihet dënimi i autorit, atëherë ndëshkohet padrejtësia e kryer. Kjo ka edhe një sinjal shoqëror.
- Në këtë mënyrë ju mbroheni kundër dhunës së pësuar, gjë që mund të jetë një hap i rëndësishëm në procesin e përpunimit.

Kundër një kallëzimi flet p.sh.:

- Një kallëzim dhe një proces gjyqësor janë të lidhur shpesh herë me ngarkesa të mëdha psikike. Parimisht ju jeni të detyruar të jepni tek policia të dhëna të sakta për ecurinë e veprës. Në vazhdimin e mëtejshëm të procesit penal – veçanërisht në shqyrtimin gjyqësor kryesor – këto të dhëna duhet të përsëriten eventualisht disa herë
- Një vendim i mundshëm pafajësie për autorin mund të çojë në një ngarkesë të shumëfishtë psikike.
- Një kallëzim nuk është gjithmonë i arsyeshëm dhe i nevojshëm, për të përpunuar të përjetuarën.

Nëse ju keni akoma nevojë për marrjen e vendimit që të bëni apo jo një kallëzim, atëherë fiksoni në çdo rast menjëherë pas veprës kujtimet tuaja me shkrim (protokolli i kujtesës). Kjo mund të jetë e dobishme për një kallëzim të mëvonshëm. Ju duhet të mundoheni atëherë që t'i shkruani me fjalët tuaja ngjarjet me aq shumë detaje dhe në mënyrën më të hollësishme që të jetë e mundur.

Ku mund të bëj unë një kallëzim?

Parimisht një kallëzim mund të bëhet në çdo kohë tek çdo zyrë e policisë. Por ju keni edhe mundësinë që të caktoni një termin tek komisariati përkatës i specializuar. Ky është në Dortmund

Komisariati i Policisë Kriminale 12
(KK 12, Telefon: 0231 132 - 0).

Në KK 12 punojnë nëpunës/e të policisë kriminale që janë kualifikuar më tej në mënyrë të veçantë. Sipas dëshirës bërja e kallëzimit realizohet nga nëpunëse të gjinisë femërore të policisë kriminale.

Për parashtrimin e kallëzimit / marrjen në pyetje ju mund të merrni me vete një person shoqëruar. Nëse gjatë marrjes në pyetje ju keni nevojë për një pushim, ju mund të luteni për një ndërprerje ose për vazhdimin në një ditë tjetër.

E drejta për padi dytësore

Që nga momenti pas bërjes së kallëzimit ekziston mundësia që juve t'ju caktohet, me kërkesë, një avokat/e për viktimën. Ky/kjo ka një të drejtë për shikimin e dosjeve dhe për të shtruar pyetje. Sapo Prokuroria ka ngritur një akuzë dhe procesi është transferuar në gjykatën kompetente, ju mund t'i bashkëngjisni procesit si „padi të dytësore“. Edhe këtu ekziston mundësia e caktimit të një avokati/avokate për viktimë.

Në shqyrtimi gjyqësor kryesor avokati/avokatja i/e caktuar – njësoj si avokati/avokatja dhe prokurori/prokurorja – ka një të drejtë refuzimi, pyetjeje dhe të kërkesës për marrjen e provave. Avokatja/avokati për viktimë mund të mbajë një pretendë në fund të procesit dhe mund të kontribuojë në këtë mënyrë në dënimin e përshtatshëm.

Nëse ju dëshironi që t'i bashkëngjiteni procesit si padi të dytësore, ju mund të menj përsipër një rol aktiv në procesin penal, ndërsa përndryshe në funksionin më tepër pasiv të dëshmitares nuk mund të ndikoni mbi procesin.

Informacione më të hollësishme për mundësinë e padisë dytësore ju mësoni në zyrën tuaj avokatore.

Shoqërimi psiko-social gjatë procesit

Ju e keni mundësinë që të shfrytëzoni në çdo moment të procesit hetimor dhe penal një shoqërim për dëshmitarë, të ashtuquajtur shoqërimin psiko-social. Shoqërueset psiko-sociale janë persona, të cilët ju ofrojnë juve si e prekura nga një vepër penale përkujdesje profesionale, mbështetje dhe informacione. Kjo mund të jetë një ndihmë, nëse ju nuk e dini se si funksionojnë hetimet policore dhe autoriteti i drejtësisë.

Një shoqërim i procesit bëhet nga pedagogje sociale me përvojë dhe është vullnetar.

Gjatë gjithë procesit hetimor dhe penal shoqëruesi i procesit/shoqëruesja e procesit është personi juaj i kontaktit, me qëllim që të reduktohen ngarkesat dhe të stabilizoheni. Ai/ajo mund t'ju shoqërojë për shembull për marrjet në pyetje dhe mund të jetë i pranishëm/ e pranishme gjatë shqyrtimit kryesor ose mund të përkujdeset për ju gjatë kohëve të pritjes tek gjykata. Shoqërimi psiko-social i procesit nuk merr përsipër asnjë këshillim juridik ose terapeutik. Ai gjithashtu nuk zhvillon asnjë bisedë me ju mbi ecurinë e veprës.

Shpenzimet e shoqëruesit psiko-social/shoqërueses psiko-sociale duhet të mbahen vetë, në raste të veçanta ka një të drejtë për caktimin e tij/saj, atëherë shpenzimet merren përsipër nga arka shtetërore.

■ Përkujdesja vetjake

Krahas përkujdesjes mjekësore dhe dijenisë suaj mbi mundësitë ligjore aspekti i përkujdesjes vetjake është me shumë rëndësi për procesin e përpunimit.

Më e rëndësishmja është që ju të perceptoni dhe dalloni se çfarë ju ndihmon dhe ju forcon. Në varësi nga ajo që ju bie ndërmend, mundohuni që ta realizoni atë dhe t'ia lejoni vetes. Nëse ju, për shembull, do ta kishit ndrydhur këmbën, atëherë ju do të silleshit gjithashtu në mënyrë të kujdesshme me vetveten.

Mund të ndihmojë, nëse ju e hiqni mendjen nga ngjarja

- kaloni kohë me njerëz të tjerë
- leximi
- hobi
- sport, aktivitete fizike

Mund të ndihmojë, nëse ju përpiquni që ta ruani rutinën tuaj të përditshme

- gjumë i mjaftueshëm
- Profesione/ punë
- kohët e pushimeve
- vakte të shëndetshme

Mund të ndihmojë që t'ua hapni zemrën njerëzve të tjerë. Nëse ju vini re që kjo është rruga e drejtë për ju, atëherë

- vendosni me vetëdije se kujt do t'i hapni zemrën.
- zgjidhni një moment dhe një vend të mirë.
- vendosni paraprakisht, për çfarë dëshironi të flisni.
- I thoni personit tuaj të kontaktit mundësisht konkretisht se për çfarë keni nevojë dhe çfarë mund t'ju ndihmonte.

Çdo grua ka nevojat e veta. Shikoni se çfarë është mirë për ju.

■ Oferta e mbështetjes e këshillimores për gra

Me orientimin e saj të njëanshëm këshillimorja u drejtohet të gjithë femrave që nga moshja 18 vjeç. Në një atmosferë plot besim dhe një hapësirë të mbrojtur ju mund të flisni mbi përvojat e dhunës dhe pasojat e tyre.

Këshillimorja për gra ofron këshillim në rast të

- një përdhunimi / shtrëngimi seksual ose një ndërhyrjeje në tentativë
- supozimit që ju keni pësuar dhunë të seksualizuar
- përvojave të dhunës në të kaluarën
- bezdisjes seksuale në jetën e përditshme në vendin e punës ose kualifikimit
- mendimit të bëni një kallëzim penal
- kërkesës për mundësi që të mbroheni vetë
- mbështetjes së të afërmeve të gjinisë femërore të të prekurave
- kërkesës për mbështetje dhe këshillim për procese gjyqësore që priten
- kërkesës për oferta terapeutike

Si organizatë e njohur për të drejtat e grave dhe zyrë e specializuar për dhunën e seksualizuar këshillimorja për gra u ofron grave të prekura këshillim individual dhe punon në mënyrë të orientuar në resurset dhe stabilizuese. Në bisedat këshilluese ju merrni informacione për procedurën e kallëzimit, mbi procesin gjyqësor dhe mundësinë e zhdëmtimit të viktimave. Përveç kësaj këshillimorja për gra ofron këshillim stabilizues sipas koncepteve terapeutike kundër traumave.

Oferta e këshillimit është falas, përveç kësaj bashkëpunëtorët e këshillimores për gra i nënshtrohen detyrimit për të heshtur, dhe sipas dëshirës këshillimet mund të bëhen në mënyrë anonime.

Ju mund të lidhni kontakt të hënë deri të enjte gjatë kohës nga ora 9-12 nëpërmjet telefonit nën

Numri i telefonit 0231 / 52 10 08

për të caktuar një termin.

Botuesi:



„Tryeza e rrumbullakët kundër dhunës shtëpiake“ e Dortmundit

„Tryeza e rrumbullakët kundër dhunës shtëpiake e Dortmundit“ punon që nga viti 2002 për një realizim të mirë të Ligjit për mbrojtjen nga dhuna në Dortmund, Gjatë 15 viteve të fundit janë krijuar për Dortmundin kushte të mira kornizë për mbrojtjen dhe mbështetjen e viktimave të dhunës shtëpiake, veçanërisht të femrave dhe fëmijëve.

Informacion për nxitjen:

Krijimi dhe printimi janë mbështetur financiarisht nga:

Ministerium für Heimat, Kommunales, Bau und Gleichstellung des Landes Nordrhein-Westfalen



Koordinimi:

Këshillimorja për gra Dortmund

Krijimi:

Martin Kräling

Përkthimet janë bërë nga ‚Auslandsgesellschaft.de gGmbH‘ (Dortmund) dhe ‚Alettera Übersetzungen‘ (Dortmund)“

Botimi i 1-rë 2018



„Tryeza e rrumbullakët kundër dhunës shtëpiake“ e Dortmundit

Përdhunimi / shtrëngimi seksual
Udhëzime dhe informacione
për gra të prekura

Adresa të rëndësishme në Dortmund:

Këshillimorja për gra Dortmund

Märkische Str. 212-218

44141 Dortmund

Tel: 0231 / 52 10 08

Shtëpia e grave Dortmund

Tel: 0231 / 80 00 81

Ambulanca e traumës

Klinika LWL Dortmund

për traumatizime akute

(deri në 6 muaj pas një vepre të dhunshme)

Marsbruchstraße 179

44287 Dortmund

Tel: 0231 / 45 03 80 00

Qendra për mbrojtjen e fëmijëve Dortmund

Gutenbergstraße 24

44139 Dortmund

Tel: 0231 / 20 64 58 0

Presidiumi i Policisë Dortmund

Mbrojtja e viktimave

Markgrafenstraße 102

44139 Dortmund

Tel: 0231 / 132-74 64 dhe 0231 / 132-74 65

Telefoni për viktimat në shkallë federale i shoqatës “WEISSER RING”

Tel: 116 006 (ora 7-22, falas)

Telefoni ndihmës Dhuna ndaj grave

Tel: 08000 116 016 (24 orë, falas)